

V E N D I M
Nr.38 datë 29.1.1993

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.536 DATË
21.12.1992 "PËR ZBATIMIN E DETYRAVE NGA MINISTRITË PËR EMBARGON NDAJ
SERBISË E MALIT TË ZI"**

Me propozimin e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pas paragrafit të parë të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.536, datë 21.12.1992, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Për mallrat e mësipërme, si dhe për materialet që lidhen me burimet energjetike, metalet e tjera, produktet kimike e kauçukun, ndalohet edhe tranzitimi i tyre sipas pikes 9 të rezolutës 787, datë 16.11.1992".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi